

RRJEDHA E PUNËS 6 – Sjellja, udhëzimet dhe etika

Veprimi 2: ndani dhe promovoni kodet e sjelljes

Çfarë dhe pse?

Një kod i mirë sjelljeje është një hap i parë thelbësor për të parandaluar dhunën ndërpersonale. Ai përcakton rregulla të qarta sjelljeje për grupet e ndryshme të përfshira në klubin tuaj sportiv.

Megjithatë, krijimi i një kodi sjelljeje është vetëm fillimi! Mënyra se si zbatohet në praktikë është vendimtare për të arritur efektin e dëshiruar brenda klubit. Më poshtë, do të gjeni këshilla praktike se si ta sillni në jetë Kodin e Sjelljes dhe politikën e mbrojtjes dhe si t'i komunikoni ato qartë dhe në mënyrë të qëndrueshme.

Në fillim të çdo sezoni, vendosni se si do ta informoni bordin e klubit, sportistët, trajnerët, anëtarët e stafit dhe profesionistët e tjerë.

Një plan komunikimi shembull është bashkëngjitur për t'ju ndihmuar të ndani politikën e mbrojtjes dhe kodet e ndryshme të sjelljes me secilin grup target brenda klubit tuaj.

Këshilla komunikimi për të gjithë klubin

- Publikoni kodet e sjelljes në faqen tuaj të internetit, dërgojini me email në fillim të sezonit, përfshijini në broshurën e mirëseardhjes dhe shfaqini në postera në tualete, etj.
- Përdorni shumë kanale komunikimi gjatë gjithë vitit për të maksimizuar shanset për të arritur të gjitha grupet target dhe për t'u siguruar që ata janë të vetëdijshëm për Kodin e Sjelljes.
- Dizenjoni një poster që thekson disa rregulla kyçe që dëshironi t'i theksoni si klub.
- Përfshini një përmbledhje të Kodit të Sjelljes në buletin e klubit tuaj ose krijoni një akronim tërheqës që pasqyron parimet e tij thelbësore.
- Sigurohuni që Oficerët e Sigurisë të prezantohen para të gjitha grupeve përpara fillimit të sezonit.
- Herë pas here caktoni një Ambasador të Kodit të Sjelljes, duke treguar se si ai/ajo ka dhënë një shembull pozitiv.

Këshilla komunikimi për anëtarët e bordit

- Prezantoheni Kodin e Sjelljes të paktën një herë në vit gjatë një mbledhjeje të bordit për të siguruar që mbetet gjithmonë në vëmendje.
- Rishikoni Kodin e Sjelljes në detaje me të gjithë anëtarët e sapoemëruar të bordit. Kjo duhet të bëhet nga kryetari i klubit ose një anëtar i caktuar i bordit dhe secili anëtar i ri duhet të nënshkruajë dokumentin.

- Teksoni rregullisht parimet e qeverisjes së mirë gjatë mbledhjeve të bordit. Merrni në konsideratë përfshirjen e një pike të përhershme në rendin e ditës mbi qeverisjen e mirë.
- Adresoni çdo shkelje të Kodit të Sjelljes nga anëtarët e bordit në mënyrë të menjëhershme dhe të përshtatshme.
- Sigurohuni që Oficerët e Sigurisë të prezantohen para anëtarëve të bordit dhe të paraqesin të paktën një raport vjetor që përmbledh numrin e raporteve të mbrojtjes të marra brenda klubit dhe mënyrën se si ato janë trajtuar.

Këshilla komunikimi për sportistët

- Përfshini sportistët në hartimin e kodeve të sjelljes (p.sh. përmes një këshilli sportistësh ose një grupi përfaqësues).
- Në fillim të çdo sezoni, zhvilloni një seancë të dedikuar me të gjitha ekipet/sportistët për të diskutuar dhe rënë dakord mbi rregullat kryesore të sjelljes brenda klubit.
- Rishikoni rregullisht Kodin e Sjelljes gjatë seancave stërvitore dhe takimeve informuese me sportistët.
- Prezantoni sportistët më të rinj me Kodin e Sjelljes në një mënyrë argëtuese dhe tërheqëse, si p.sh. përmes një kuizi ose loje interaktive.
- Sigurohuni që trajnerët dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të jenë plotësisht të informuar mbi rregullat e sjelljes për sportistët dhe që t'i zbatojnë ato.
- Komunikoni qartë se kujt mund t'i drejtohen sportistët nëse dikush nuk respekton Kodin e Sjelljes.

Këshilla komunikimi për trajnerët, stafin dhe profesionistët e tjerë

- Përfshini trajnerët, anëtarët e stafit dhe profesionistët e tjerë në hartimin e Kodit të Sjelljes për të nxitur ndjenjën e pronësisë dhe angazhimit.
- Që në fillim, sigurohuni që të keni një diskutim të hapur dhe konstruktiv me trajnerët, stafin dhe profesionistët e tjerë mbi përmbajtjen dhe rëndësinë e Kodit të Sjelljes, për të garantuar një mirëkuptim të përbashkët.
- Për trajnerët, stafin dhe profesionistët e rinj, prezantoni zyrtarisht Kodin e Sjelljes, për shembull duke e përfshirë atë në kontrata ose marrëveshje dhe duke kërkuar nënshkrimin e tij.
- Komunikoni qartë se kujt mund t'i drejtohen trajnerët, anëtarët e stafit dhe profesionistët e tjerë nëse vërejnë apo përfshirë një shkelje të Kodit të Sjelljes.
- Merrni masa të shpejta dhe të përshtatshme kur trajnerët, anëtarët e stafit dhe profesionistët e tjerë shkelin Kodin e Sjelljes.

Politika e Mbrojtjes nga Dhuna dhe Abuzimi (Fillimi i sezonit sportiv)

	Bordi Klubit	Stafi Klubit	Trajnerë	Sportistë	Prindër/Familjarë
Gusht	<ul style="list-style-type: none"> Propozimet për mbrojtjen e politikës gjatë mbledhjes së bordit. Rishikimi i Kodit të Sjelljes gjatë mbledhjes së bordit. Nënshkrimi i Kodit të Sjelljes nga anëtarët e rinj të bordit pas emërimit. Prezantimi nga Oficeri i sigurisë (OS) + përcaktimi i mandatit të OS brenda klubit. 	<ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Kodit të Sjelljes pas takimit + nënshkrimi. Rifreskimi i kodeve të ndryshme të sjelljes në klub. Prezantim nga OS. Kërkimi i një kopjeje të dosjes penale nga kushdo që ka kontakt me të mitur, (nëse është e mundur, në vendin tuaj). 	<ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Kodit të Sjelljes pas takimit + nënshkrimi. Rifreskimi i Kodit të Sjelljes gjatë takimit të parë të trajnerëve. Prezantim nga OS. Kërkimi i një kopjeje të dosjeve kriminale nga trajnerët që punojnë me të mitur, p.sh. trajnerë të sapoemëruar (nëse është e mundur, në vendin tuaj) Vendosja e një posterit me rregullat e sjelljes në dhomën e trajnerëve. 	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i një sesioni informativ për shqyrtimin dhe prezantimin e Kodit të Sjelljes nga OS. Vendosja e posterave me rregullat e sjelljes në dhomat e zhveshjes, tualetet, mensën, ekranet etj. 	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i një sesioni informativ për shqyrtimin dhe prezantimin e Kodit të Sjelljes nga OS. Vendosja e posterave me rregullat e sjelljes në dhomat e zhveshjes, tualetet, mensën, ekranet etj.
Shtator		<ul style="list-style-type: none"> Trajnim për politikat e sigurisë së klubit 		<ul style="list-style-type: none"> Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. 	<ul style="list-style-type: none"> Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes
Tetor			<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i një seminari për trajnerët mbi sigurinë 	<ul style="list-style-type: none"> Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. Organizimi i një seminari për sportistët mbi Sigurinë 	<ul style="list-style-type: none"> Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes

Nentor		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi në intranet për OS dhe Kodin e Sjelljes. 		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes.
Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Takimi me anëtarët e bordit: OS ofron një pasqyrë të një numri raportesh brenda aktiviteteve të ndryshme të klubit + qasje. 		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Takimi me trajnerët: OS ofron një pasqyrë të një numri raportesh + qasje. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. ▪ Diskutim i ndërmjetëm me secilin ekip: si ndihen të gjithë? 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes
Janar		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi në intranet për OS dhe Kodin e Sjelljes. ▪ Trajnim mbi politikat e Sigurisë për punonjësit e rinj. 		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. ▪ prezantim OS. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. ▪ prezantim OS.
Shkurt				<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes
Mars	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përfshirja e politikave të sigurisë në axhendën e mbledhjeve të bordit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi në intranet për OS dhe Kodin e Sjelljes. 		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes
Prill				<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes

Maj				<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes
Qershor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi I Politikave të sigurisë si pikë në rendit e ditës në mbledhjen e bordit 		<ul style="list-style-type: none"> ▪ OS ofron një përmbledhje të një numri raportesh + qasje. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi mujor: Kodi i Sjelljes në qendër të vëmendjes. ▪ Feedback për rezultatet e politikave të sigurisë
Korrik					